



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELNË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1555 prot

Tepelenë, më 01.09.2025

V E N D I M

Nr. 51, datë 29.08.2025

“PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË NJË MJEDISI PUNE NË SHKOLLËN “SINAN KËRPI” LEKDUSH, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH BASHKIA TEPELENË”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 29.08.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë , mbështetur në nenin 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 23 , të nenit 54 shkronja “ll”, dhe nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, relacionit të Drejtorisë së Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social,

V E N D O S I

- 1- Vënien në dispozicion të një mjedisi pune në shkollën “Sinan Kërpi” Lekdush, në Njësinë Administrative Kurvelesh , Bashkia Tepelenë, për përdorim të Kryesisë së fshatit Lekdush, sipas kushteve të mëposhtme :
 - a) Ambjenti “Salla e mesuesve” do të vihet në dispozicion të takimeve të Kryesisë së fshatit Lekdush vetëm të shtunën dhe të dielën gjatë gjithë ditës dhe ditët e javës pas orarit mësimor.
 - b) Ambjenti “Salla e mësuesve” do të vihet në dispozicion si bibliotekë e shkollës gjatë gjithë orarit mësimor por dhe pas tij në funksion të nxënësve dhe komunitetit të zonës.
 - c) Përjashtimisht në rastet e emergjencave ky ambjent do të jetë në funksion të Kryesisë së fshatit vetëm me konfirmim të Administratorit të Njesisë Administrative Kurvelesh pa çënuar procesin mësimor.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social dhe Njësia Administrative Kurvelesh.

3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miraturar me 10 (dhjetë) vota
Vota Pro 10 (dhjetë)vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 01.09.2025

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI

